

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, procesmbajtës në çështjen penale kundër të akuzuarit A.R. nga Gjilani, rr. "... nr...., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1. nënpar.1 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës të (KPK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.584/2017 të datës 13.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.584/2017 të datës 13.12.2018, ndryshohet vetëm sa i përket vendimit për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 2.000 (dy mijë) €, të cilin dënim duhet ta paguajë menjëherë pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë e nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, dënimi me gjobë revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me 180 ditë burg.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.584/2017 të datës 13.12.2018, të akuzuarin A.R., e ka shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1. nënpar.1 lidhur me nenin 23 të KPK, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Gjykata e shkallës së parë, bazuar në nenin 47 të KP dhe me pëlqimin e të akuzuarit, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 180 ditësh ia ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1.200 (një mijë e dyqind) €, të cilin dënim duhet ta paguajë menjëherë pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë e nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, dënimi me gjobë revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me 180 ditë burg. I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. I dëmtuari R.H., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan vetëm për shkak të vendimit lidhur me saksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet, aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë me burg efektiv.

Prokurori i Apelit i Kosovës, me shkresën PPA/II.nr.122/2019, datë 11.02.2019, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënimin dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë -me burg efektiv

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se

Ankesa është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Prokurori Themelor në ankesë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk i ka shqiptuar të akuzuarit dënimin e merituar dhe se dënimin e ka zbutë deri në atë masë sa që bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit dhe nenet 74, 75 e 76 të KPRK. Sipas ankesës, gjykata e shkallës së parë gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit ka mbivlerësuar rethanat lehtësuese, rrethanat lehtësuese çfarëdo qofshin ato assesi në rastin konkret nuk kanë guxuar të vlerësohen se janë të asaj rëndësie që të ndikojnë që dënimin e parashikuar ligjor për veprën penale të kësaj natyre, që dënimi të zbutet gjer në këtë masë, ku të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar në kohën kur të gjitha rrethanat e kryerjes së kësaj veprë penale pa mëdyshje tregojnë qartë se ky dënim është jo proporcional dhe jo adekuat me peshën e kësaj veprë penale dhe shkallën e përgjegjesisë së kryerësit të veprës penale dhe se sipas ankesës, me një dënim të tillë nuk mund assesi të ndikojë tek i pandehuri që në të ardhmen mos të kryej vepra penale të tjera të kësaj natyre. Prokurori me ankesë ka potencuar se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, edhe pse ato ekzistojnë, si motivi i kryerjes së veprës penale, dashja dhe rrezikshmëria e naltë, rrethana që po të ishin vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, me siguri dënimi ndaj të akuzuarit, do të ishte më i ashpër.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit janë të bazuara, rrethanat lehtësuese janë mbivlerësuar ndërsa dënimi me burg i zëvendësuar me dënim me gjobë i shqiptuar në rastin konkret është tejet i butë dhe nuk është adekuat me rrezikshmërinë dhe rrethanat e veprës penale dhe se me dënimin e shqiptuar nuk do të arrihet qëllimi dhe efekti i dënimit.

Kjo Gjykatë duke pasur parasysh peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjesisë penale të të akuzuarit, mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe vlerën e dëmit të shkaktuar me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete, konsideron se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj në këtë drejtim Gjykata e Apelit ndryshoi aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, duke ia ashpërsuar dënimin të akuzuarit dhe duke i shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 2.000(dy mijë) €, me bindje se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe adekuat me përgjegjësinë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit- preventiva individuale dhe ajo e përgjithshme.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.101/2019, me 22.02.2019

Zyrtari ligjor,
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit,
Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit
Shqipe Qerimi
Afrim Shala